



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në propozim të datës 30.05.2022 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM

FORMIMI I KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS SË BIZNESEVE QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e draft rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë në këtë përbërje;

1. **Bahri Selimi**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
2. **Antoneta Ejupi**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit
3. **Besnik Mulliqi**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
4. **Vigan Salihu**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
5. **Ekrem Rrahmani**, anëtar nga radhët e Kuvendit
6. **Drita Pajaziti**, anëtare nga radhët e Kuvendit
7. **Bashkim Sylja**, anëtar nga radhët e Kuvendit
8. **Arbnor Fazliu**, anëtar nga radhët e Kuvendit
9. **Gazmend Islami**, anëtar nga radhët e Kuvendit

Kryesuesi i Komisionit, rregullat dhe mbarëvajtja e punëve dhe takimeve caktohen në takimin e parë të Komisionit, i cili ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, ngritët duke marrë për bazë përfundimin e mbështetur nga diskutimet e zhvilluara në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur 29 prill 2022 (në pikën e 12 të rendit të ditës) që në mbledhjen e radhës të formohet një komision i përbashkët ad-hoc nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, për përgatitjen e draft rregullores së re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të rregullores së re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, dhe atë në një afat sa më optimal të mundshëm.

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-020/04-0053358/22
Podujevë, datë: 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha